



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 1 korrik 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Leje
për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00854 (Vendimi për Informacionin
Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë)**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullave 9(5)(a), 76 dhe 77(1) dhe (3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 3 dhjetor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake të përcaktonte një protokoll për trajtimin e informacionit konfidencial dhe kontakteve me dëshmitarë.²

2. Më 24 qershor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës Kundërshtare ose të një Pjesëmarrësi” (“Vendimi Kornizë”).³

3. Më 29 qershor 2022, Mbrojtjet e z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi (“Mbrojtja”) dorëzuan një kërkesë të përbashkët për zgjatjen e afatit për dorëzimin e kërkesës për leje për apelim të Vendimit Kornizë (“Kërkesa”),⁴ në të cilën parashtuan se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit deri të martën, 18 korrik 2022, duke pasur parasysh: (i) gjatësinë e konsiderueshme të Vendimit Kornizë; (ii) risitë që ai sjell dhe mungesën e jurisprudencës së mëhershme të Dhomës së Gjykatës së Apelit në

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00594, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë*, 3 dhjetor 2021, publik, para. 1, 7.

³ KSC-BC-2020-06, F00854, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës Kundërshtare ose të një Pjesëmarrësi*, 24 qershor 2022, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00857, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00854 (Vendimi për Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë)*, 29 qershor 2022, publik, para. 1, 7.

lidhje me kontaktet me dëshmitarë; dhe (iii) çështjet komplekse procedurale dhe kushtetuese në fjalë që ndikojnë në të drejtat e të akuzuarve.⁵

4. Më 30 qershor 2022, ZPS-ja u përgjigj se nuk kundërshtonte një zgjatje të arsyeshme të afatit të lejes për apelimin e Vendimit Kornizë, duke parashtruar se zgjatja e kërkuar nga Mbrojtja është e tepruar dhe e papërligjur, por duke ia lënë Gjykatësit të Procedurës Paraprake marrjen e vendimit për zgjatjen e përshtatshme të afatit.⁶

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, paneli mund të zgjasë ose shkurtojë *proprio motu*, ose nëse i tregohen arsye të vlefshme, afatet e përcaktuara prej Rregullores apo prej panelit.

6. Sipas rregullës 76 të Rregullores, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Rregullore, përgjigja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh prej dorëzimit të mocionit, kurse kundërpërgjigja ndaj përgjigjes dorëzohet brenda pesë (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes.

7. Sipas rregullës 77(1) të Rregullores, në rastet kur një palë kërkon të apelojë vendimin e një paneli që nuk është i apelueshëm sipas Ligjit dhe Rregullores, pala në fjalë i parashtron kërkesë për leje për apelim të ndërmjetëm panelit që ka nxjerrë vendimin e kontestuar brenda shtatë (7) ditësh prej daljes së vendimit.

8. Sipas rregullës 77(3) të Rregullores, kur një palë kërkon leje për të apeluar vendimin e një paneli, paneli nxjerr vendim me arsyetim brenda shtatë (7) ditësh

⁵ Kërkesa, para. 5.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00860, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00854*, 30 qershor 2022, publik, para. 1.

prej parashtrimit të fundit të palëve apo, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave.

III. DISKUTIM

9. Pasi shqyrtoi arsyet e parashtruara nga Mbrojtja, në veçanti gjatësinë e Vendimit Kornizë, dhe risitë e kompleksitetin e çështjeve të përfshira në të, duke mbajtur parasysh afrimin e periudhës së pushimit të gjykatës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit përkatës të përcaktuar në Rregullore, për t'i mundësuar Mbrojtjes të dorëzojë kërkesën për leje për apelim të Vendimit Kornizë. Rrjedhimisht, nëse Mbrojtja vendos të kërkojë leje për apelim, ajo urdhërohet ta bëjë këtë deri të hënën, 18 korrik 2022.

10. Për të njëjtat arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton, *proprio motu*, zgjatjen e afatit të dhënies së përgjigjes së ZPS-së ndaj kërkesës (kërkesave) për leje për apelim, dhe të afatit të dorëzimit nga Mbrojtja të kundërpërgjigjes ndaj përgjigjes së ZPS-së. Rrjedhimisht, nëse ZPS-ja vendos të përgjigjet, ajo urdhërohet ta bëjë këtë deri të hënën, 1 gusht 2022, dhe nëse Mbrojtja vendos të kundërpërgjigjet, urdhërohet ta bëjë këtë deri të hënën, 15 gusht 2022. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake zgjat afatin e nxjerrjes së vendimit në lidhje me kërkesën (kërkesat) për leje për apelim, deri të premten, 26 gusht 2022.

IV. VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON** Kërkesën;
- (b) **ZGJAT** afatin e dorëzimit nga Mbrojtja të kërkesës (kërkesave) për leje për apelim të Vendimit Kornizë deri të hënën, 18 korrik 2022;

- (c) **ZGJAT**, *proprio motu*, afatin e dorëzimit nga ZPS-ja të përgjigjeve ndaj çdo kërkesë të Mbrojtjes për leje për apelim deri të **hënën, 1 gusht 2022;**
- (d) **ZGJAT**, *proprio motu*, afatin e dorëzimit të kundërpërgjigjeve të Mbrojtjes ndaj çdo përgjigjeje të ZPS-së deri të **hënën, 15 gusht 2022;** dhe
- (e) **ZGJAT** afatin për nxjerrjen e vendimit në lidhje me kërkesën (kërkesat) për leje për apelim të Vendimit Kornizë deri të **premtën, 26 gusht 2022.**

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 1 korrik 2022
Në Hagë, Holandë.